Kronikë

Vlorë, arrestohet 35 vjeçari nga Shkodra! Në çantën e shpinës kishte pistoletë me silenciator me fishek në fole gati për qitje (EMRI)

Një 35 vjeçar nga Shkodra është arrestuar në Vlorë teksa lëvizte më me armë zjarri me silenciator dhe me fishek në fole, gati për qitje.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
8 Gusht, 12:20 | **Përditesimi: 8 Gusht, 12:24**

Një 35 vjeçar nga Shkodra është arrestuar në Vlorë teksa lëvizte më me armë zjarri me silenciator dhe me fishek në fole, gati për qitje. Në pranga në kuadër të operacionit policor të koduar "Silenciatori", u vu në pranga shtetasi Amarildo Nikolli (Xhanej).

Njoftimi i policise

LEXO EDHE:
Çështja Beleri, Ministri i jashtëm grek: Nëse shkarkohet, marrëdhëniet mes dy vendeve do përkeqësohen

Shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, si rezultat i kontrollit permanent të territorit, për garantimin e rendit dhe të sigurisë, bazuar në informacionet e siguruara nga inteligjenca policore, për një shtetas që qarkullonte me armë zjarri me vete, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Silenciatori".

Në kuadër të këtij operacioni, në lagjen "Uji i Ftohtë", shërbimet e Policisë kanë lokalizuar, kapur në flagrancë dhe kanë arrestuar shtetasin A. N. (Xh.), 35 vjeç, banues në Shkodër.

Gjatë kontrollit fizik ndaj këtij shtetasi, dhe në çantën e tij të shpinës, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri pistoletë me silenciator, me fishek në fole, gati për qitje, një sasi municioni lufatrak, doreza dhe kapuç.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Rënda, të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, vijojnë hetimet e thelluara për zbardhjen e rrethanave të këtij rasti dhe të qëllimit të këtij shtetasi.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

S.G/LR/Shqiptarja.com

TAG: Vlore | Amarildo Nikolli

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Për tu ulur numri i aksidenteve duhet të rriten:

Gjobat | Kontrollet | Ndërgjegjësimi

Lajme të tjera

Ishin vendosur pa leje, policia sekuestron 160 çadra në plazhin publik të Sarandës! Persona të paautorizuar u merrnin para pushuesve
8 Gusht, 10:20



Vrasja e ndërtuesit në Vlorë, djali i anëtares së KLP sekser pronash, sherri për një apartament! Dëshmia e Rei Metës: Nuk kisha qëllim ta vrisja
Armand Xhelili
8 Gusht, 09:13

Punimet në aeroportin e Vlorës, shtyhet me disa muaj ulja e avionit të parë
8 Gusht, 08:34

VIDEOLAJM/ Dyndja e turistëve në Vlorë shton trafikun! Radhë e gjatë automjetesh në Lungomare
7 Gusht, 21:37

Aksident pranë nënkalimit të Novoselës, shoferi humb kontrollin e mjetit dhe del nga rruga! Përmbyset 'Fuoristrada', dy të plagosur (VIDEO)
7 Gusht, 18:26

Ministri i Brendshëm nga Vlora optimist: Jemi në rrugë të mbarë për të prerë fijet brenda Policisë që rrjedhin informacion dhe tradhtojnë
7 Gusht, 15:44

'Shqipëria turistike'/ Çifti zviceran hap restorant buzë liqenit të Mursisë në Konispol: Shqipërinë e zbuluam gjatë pushimeve, turizëm special
Limos Didani
7 Gusht, 14:34

Lëvizte nëpër qytet me kanabis në makinën e vjedhur në Spanjë, arrestohet 30-vjeçari në Vlorë
7 Gusht, 13:20

Dhunoi për vdekje inxhinierin në Vlorë, autori është djali i anëtares së KLP-së! Shkak, borxhi për një apartament, i riu u arrestua pas 4 orësh (VIDEO)
7 Gusht, 13:09

REPORTAZHI i 'La Repubblica'/ Shqipëri, në Maldiven e Europës, plazhi i fundit i pushimeve me shezlong dhe çadër për 10 euro
7 Gusht, 10:57

Siguria në plazhe, bllokohen 12 mjete lundruese në Sarandë dhe Vlorë, gjobiten drejtuesit
6 Gusht, 16:35

FOTO/ E kishte humbur në afërsi të hotelit, policët gjejnë dhe i dorëzojnë turistit portofolin në Sarandë
6 Gusht, 14:44

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje